



E premte, 28 tetor 2016

NJOFTIM

ZRRE me ndihmën e NARUC krijon bazën elektronike të të dhënave për konsumatorë dhe ndërton qasje proaktive për informim dhe transparencë

Përfaqësues të Agjencionit Kombëtar të Komisioneve Rregullative të Shërbimeve Publike (National Agency of Regulatory Utilities Commissions, **NARUC**) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) kanë qëndruar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) për të përpiluar së bashku me stafin e ZRRE bazën elektronike të të dhënave të konsumatorëve.

ZRRE dhe NARUC, në mbështetjen financiare të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), janë në një partneritet të fuqishëm Rregullativ që nga viti 2008. Ky partneritet i ka mundësuar stafit profesional të ZRRE të përfitoj nga praktikat më të mira rregullative qindrvajeçare që kanë rregullatorët e SHBA.

Qëllimi i aktivitetit të fundit të zhvilluar gjatë periudhës prej 24 deri 28 tetor 2016, ishte përmirësimi i shërbimeve të përkujdesjes ndaj konsumatorëve. Me këtë rast ekspert të NARUC dhe ata të ZRRE kanë punuar në krijimin e bazës elektronike të të dhënave të konsumatorëve.

Krijimi i kësaj baze të të dhënave është vlerësuar si një hap i rëndësishëm në intensifikimin e përkujdesjes që ZRRE ka ndaj konsumatorëve, duke krijuar kështu kushte më të përshtatshme për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve në kohë më të shkurtër si dhe për të intensifikuar monitorimin e operatorëve të sektorit të energjisë në qasje e tyre ndaj konsumatorëve.

Gjithashtu ekspert të NARUC kanë punuar me stafin e ZRRE në hartimin e Kornizës së Planit të Komunikimit e cila ka për qëllim përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në proceset rregullative. Në këtë drejtim ekspert të NARUC kanë zhvilluar po ashtu takime me operatorët e sektorit të energjisë, përfaqësues të Kuvendit të Kosovës dhe gazetarë. Këto takimi i kanë ofruar ekspertëve të NARUC një përshtypje të përgjithshme për sektorin dhe gjetjen e mënyrës më të përshtatshme për përfshirjen e këtyre palëve në proceset rregullative.

Ushtuesi i detyrës së Kryesuesit të Bordit të ZRRE, Z. Krenar Bujupi, me këtë rast ka falënderuar USAID dhe NARUC për mbështetjen e pandërprerë që i kanë dhënë ZRRE-së në zhvillimin e kapaciteteve të saj profesionale, duke ndikuar kështu në përmirësimin e përgjithshëm të funksionimit të sektorit të energjisë, sektor ky esencial për zhvillimin e ekonomik të vendit.